



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

03.06.2014

Reagim i AKP-së ndaj uzurpatorit të INA-së

Prishtinë - Agjencia Kosovare e Privatizimit reagon ndaj deklaratave të pabaza dhe pa asnjë argument që bënë dje uzurpatori i pronave shoqërore, kompania “Kosova Petrol”, si shprehje e pakënaqësisë me shpalljen publike të Agjencisë për dhënie me qira të 10 pikave të karburanteve që janë në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore.

Para se të jepen deklarata e kritika njollosëse, duhet të shqyrtohet mirë infrastruktura ligjore dhe të shfrytëzohen mundësitë ligjore që janë në fuqi për të adresuar pakënaqësitë jo vetëm në këtë rast, por në çdo rast që del gjatë procesit të privatizimit.

E kemi thënë shumë herë dhe e përsërisim se Ligji i AKP, i nxjerrë nga ana e deputetëve të Kuvendit të Kosovës - neni 5.1. përcakton qartë se “Agjencia ka kompetenca ekskluzive që të administroj: ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo; të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekte apo jo, të cilat kanë qenë në pronësi shoqërore me ose pas 22 marsit 1989...”.

Në lidhje me pikat e karburanteve të “Ina Trgovina”, “Kosova Petroli” ka pasur një marrëveshje të lidhur me autoritetet e UNMIK-ut, para se të ekzistonte ish AKM-ja. Nuk ka pasur marrëveshje me ish AKM-në dhe as me AKP-në. Në AKP nuk është paraqitur ende asnjë provë apo dëshmi që “Kosova Petrol” ka paguar qira për shfrytëzimin e këtyre pikave të shitjes së karburanteve. AKP menjëherë pas themelimit në vitin 2008 u ka bërë me dije me shkrim të gjitha ndërmarrjeve shoqërore se qiradhëniet duhet të aprovohen paraprakisht nga AKP, në të kundërtën ato konsiderohen jo valide. Borxhi i llogaritur deri më tani për shfrytëzimin e këtyre pronave të ndërmarrjeve shoqërore shkon në rreth 2 milionë euro dhe deri më tani kjo kompani nuk ka bërë ndonjë pagesë.

AKP sqaron se këto prona janë shoqërore dhe nuk janë pronë e kompanisë “Kosova Petrol”. Edhe Gjykata ia ka rrëzuar kërkesën për pronësi. Prandaj janë tërësisht të pabaza pretendimet e tyre mbi pronësinë e pikave të karburanteve. “Kosova Petrol” nuk zotëron asnjë pikë të karburanteve të pronësisë së INAS në territorin e Republikës së Kosovës, përveç se ka të uzurpuara prona shoqërore.

AKP fton edhe një herë që t’i përgjigjen shpalljes publike të Agjencisë për qiradhënie të gjithë ofertuesit që veprojnë në mirëbesim në pronën shoqërore dhe të ofertojnë për të zhvilluar veprimtarinë në këto pika të karburanteve.

Rr. Ilir Konushevci No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org

FUND